

# Tirana Art Lab

**Ekspozitë Performative # 2**

**Rivizitim: Komuna e Parisit**

**Ekspozitë performative me Rena Raedle & Vladan Jeremic dhe me kolegë të ftuar Valentina**

**Bonizzi, Raino Isto, Filip Jovanovski**

**Kuruar nga Adela Demetja**

**Hapja: E shtunë 5 Tetor, Ora 19:00**

**Orët e hapjes: 6 - 12 Tetor, Ora 16:00 - 20:00**

**Adresa e Re: Rruga Gjin Bue Shpata, Pallati Nr. 5, Tiranë**

**(Tek Stadiumi Dinamo, pranë Best Western Nov Hotel)**

Tirana Art Lab për rreth pesë vjet ka kryer aktivitetet e saj në katin e parë të një banese me pesë kate në Tiranën e Re pranë lagjes me emrin Komuna e Parisit. Pak ose asnjë nga banorët e kësaj lagjeje në rritje nuk janë të vetëdijshëm sot për konotacionin historik dhe rëndësinë që lidhet me emrin Komuna e Parisit. Prandaj ekspozita e dytë performative zhvillohet nën titullin Rivizitim: Komuna e Parisit dhe ndër të tjera synon të pasqyrojë rëndësinë e ideve të Komunës së Parisit dhe asaj që kjo ngjarje përfaqëson në kontekstin e betejave artistike, urbane dhe sociale.

Komuna e Parisit shënon një shembull historik të subjektivizimit politik të klasës punëtore, në një kohë kur institucionet e reja të artit borgjez si academia dhe sallonet e artit lulëzonin në Paris. Gustave Courbet ishte një ndër shumë punëtorë kulturorë dhe artizanë që u solidarizuan me komunarët dhe morën funksione të rëndësishme në 72 ditët e vetëqeverisjes së udhëhequr nga punëtorët e Parisit. Praktika e tij dhe e artistëve të tjerë ishte një shembull i hershëm i parimit avangardë që arti dhe jeta duhet të shkrihen në një, dhe që artistët duhet të bëhen subjekt politik në mbështetje të klasës punëtore. A kanë këto praktika ndonjë rëndësi në Shqipërinë bashkëkohore dhe periferitë e tjera evropiane dhe në cilin nivel mund të ri-aktualizohen ato? Cilat praktika artistike mund të luajn një rol domethënës në kontekstin e lëvizjeve shoqërore?

Ekspozita performative sjell sëbashku praktika artistike nga Rena Raedle & Vladan Jeremic dhe kolegë të ftuarit Valentina Bonizzi, Raino Isto, Filip Jovanovski dhe diskuton funksionin dhe vlerën e përdorimit të një veprë arti brenda mjedisit shoqëror, mënyrat e pjesëmarrjes dhe mundësitë e organizimit të artistëve. Ekspozita është një punë në zhvillim e cila do të pësojë ndryshme dhe transformim gjatë gjithë kohëzgjatjes.

Ekspozitë Performative është një format i ri i filluar nga Tirana Art Lab - Qendra për Art Bashkëkohor me qëllim zbërthimin e ekspozitës si format dhe bërjes publike të proceseve artistike krijuese dhe të kurimit përmes performativitetit. Gjithashtu synon të gjejë mënyra për të përfshirë në procesin e ekspozimit mjetet dhe kushtet e prodhimit artistik që shkojnë përtej vetë ngjarjes ekspozuese. Koncepti i Ekspozitës Performative synon gjetjen e mënyrave të reja të ekspozimit dhe kurimit, të cilat tejkalojnë tiparet e përkohshme / unike të ekspozitës bashkëkohore dhe propozojnë mënyra të qëndrueshme për të punuar së bashku.

Rena Raedle & Vladan Jeremic janë artistë me banim në Beograd. Praktika e tyre artistike e bazuar në hulumtim përfshin vizatim dhe tekst, video, fotografi, instalacion dhe ndërhyrje në hapësirën publike. Në praktikën e tyre bashkëpunuese Rena & Vladan eksplorojnë marrëdhëniet midis artit dhe politikës, duke vënë në dukje kontradiktat e shoqërive të sotme dhe duke zhvilluar potenciale transformuese të artit në kontekstin e betejave shoqërore. Ata angazhohen në debate aktuale, luftojnë në bashkëpunim me lëvizjet shoqërore dhe shpërndajnë veprat e tyre të artit përmes riprodhimit në media të ndryshme. Ata së fundmi kanë ekspozuar në Muzeun e Brooklyn, NY (AgitProp !, 2016); Salloni i 56 I Tetorit, Beograd (2016); Muzeu i Artit Bashkëkohor, Ljubljana (2016); EKKM, Tallinn (2016); District, Berlin (2017); Autrostrada Biennale, Prizren (2017); Politika e Disonancës në kuadër të Manifesta 12, Palermo (2018); MMOMA, Moskë (2018); <rotor> Steirischer Herbst, Graz (2018); Galleria del Progetto, Politecnico di Milano (2019); Muzeu Ndërkulturor, Oslo (2019) dhe MoCA Shkup (2019).

Me mbështetjen e Goethe-Zentrum Tiranë.

## PROGRAMI

E Martë 8 Tetor 2019, ora 19:00

Filip Jovanovski  
Kjo ndërtesë flet vërtet  
Bisedë dhe diskutim

Filip Jovanovski do të prezantojë projektin e tij performativ "Kjo ndërtesë flet vërtet", i cili mori çmimin Golden Triga në Quadrennialen e Pragës në vitin 2019. Performanca dhe instalimi paraqesin një arkiv të ngjeshur të përvojave dhe dëshmimeve, lidhjeve dhe marrëdhënieve të mbledhura dhe krijuara gjatë një projekti komunitar. Ky projekt pati nismën e tij në vitin 2015 në kinemanë e Ndërtesës Rezidenciale të Hekurudhave në Shkup.

Filip Jovanovski është një artist vizual dhe aktivist civil. Ai u diplomua në Fakultetin e Arkitekturës, Shkup në vitin 2010 dhe mbaroi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Arteve të Bukura, Shkup në vitin 2012. Filip Jovanovski punon në medime të ndryshme dhe eksploron lidhjet ndërdisiplinore midis teatrit, videos, filmit dhe instalacioneve hapësinore. Punimet e tij artistike janë shndërrime të kategorive politike dhe shoqërore në imazhe hapësinore.

E Mërkurë 9 Tetor 2019, ora 19:00

Raino Isto  
Meta-piktura dhe Realizmi Socialist Shqiptar  
Prezantim dhe diskutim

Raino Isto do të flasë për pikturën *Zëri i Masës*, vepër e piktorit shqiptar Sali Shijaku, përfunduar më 1974. Ai propozon që duke lexuar me kujdes këtë vepër mund të zbulojmë disa nga marrëdhëniet e hapura mes pikturave dhe 'realitetit' në artin e Realizmit Socialist Shqiptar, duke vënë në dukje tensionet dhe mundësitë e shfaqura gjatë procesit të vëzhgimit të artit pamor dhe dëgjimit të të tjerëve të flasin për të. Raino Isto është historian arti, kurator, dhe artist. Aktualisht banon në Michigan, në ShBA, ku punon si redaktor tek *ARTMargins Online* dhe lektor pranë Mott Community College. Hulumtimet e tij trajtojnë ndërlidhjet e ndërjegjes historike me fantazitë kolektive gjatë periudhave të socializmit dhe kapitalizmit neoliberal në vendet të ish-blokut lindor. Raino është doktoruar pranë Universitetit të Maryland-it, dhe vitin e kaluar ka qënë 'fellow' tek Getty Research Institute në Los Angeles. Artikujt e tij studimorë janë botuar mes të tjerash në revista të ndryshme shkencore si *Journal of Contemporary Chinese Art*, *Third Text*, *Extrapolation*, *Science Fiction Studies*, dhe *The Getty Research Journal*.

E Mërkurë 10 Tetor 2019, ora 19:00

Valentina Bonizzi  
Shënime për një deputet  
Bisedë dhe diskutim

Si mund të ofrojë arti një model apo thjesht një hapësirë reflektimi për zhvillimin e mikro socio-ekonomive të qëndrueshme? Si ekzistojmë ne brenda ligjit dhe çfarë do të thuhet për të në fund? Këto janë disa prej pyetjeve që zbërthejnë punën e Valentina Bonizzit gjatë viteve 2017 dhe 2019 në Tiranë. Gjatë kësaj periudhe ajo ka qënë e përfshirë në projekte të zhvilluar në Qendrën për Hapje dhe Dialog dhe në qytetin e Kamzës së bashku me grupin aktivist ATA.

E karakterizuar nga kërkimi në arkiva dhe komunitete, puna e Valentina Bonizzit nxjerr në pah çështjet e drejtësisë sociale në lidhje me politikën e kohës në kontekste specifike. Ajo punon me një larmi mediumesh si film, fotografi, letërsi, tingull dhe veprimet në hapësirat publike. Bonizzi mban një Master nga Shkolla e Artit në Glasgow dhe një Ph.D (financuar nga AHRC) nga DJCAD, Universiteti i Dundee.

E Shtunë 12 Tetor 2019, ora 19:00

Rena Raedle & Vladan Jeremic & kolegë të ftuar  
Rivizitim: Komuna e Parisit  
Hapësira për ndërhyrje